



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERËT PUBLIKË**

Nr. _____ prot.

Tiranë, më 28.6.2024

Lënda: Bisedime përfundimtare të Komisionerit Publik, para trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në çështjen ankim kundër vendimit nr. 657, datë 28.4.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, z. Periand Teta.

Baza ligjore: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”

Drejtuar: Kolegjit të Posaçëm të Apelit pranë Gjykatës Kushtetuese

Të nderuar anëtarë të trupit gjykues,

Në përfundim të këtij shqyrtimi gjyqësor, në referencë të nenit 302 dhe 303 të Kodit të Procedurës Civile, pasi u shqyrtuan dhe iu nënshtruan debatit gjyqësor të gjitha kërkimet dhe propësimet e palëve, si dhe provat e administruara, Komisioneri Publik, duke i qëndruar të gjitha shkaqeve të ankimit dhe parashtrimeve me shkrim të depozituar në seancën e datës 25.6.2024, pasi vlerësoi aktet dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit pas riçeljes së hetimit gjyqësor nga ana e Kolegjit, vlerëson sa më poshtë.

Subjekti i rivlerësimit, në parashtrësën para Kolegjit datë 25.6.2024, ka kërkuar lënien në fuqi ose prishjen e vendimit të Komisionit nr.657/2023 dhe urdhërimin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për vijimin e procesit të rivlerësimit.

1. Lidhur me kërkimin alternativ të subjektit, për vijimin e procesit të rivlerësimit, sqarojmë para Kolegjit, siç subjekti ka parashtruar edhe në Apelin -kundërshtues kundër ankimit nr.208/5, datë 12.5.2023 të Komisionerit Publik, se ka qenë dakort me rezultatet e

hetimit administrativ, kur në përfundim të hetimit, me email datë 20 Prill 2023 drejtuar Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, ka konfirmuar dakortësinë e tij me përfundimin e procesit të rivlerësimit pa një vendim përfundimtar, bazuar në nenin 165 /2 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve” dhe nenin 103 të K.Pr. Administrative. Bazuar në këtë dakortësi me arsyetimin ligjor dhe logjik të Komisionit, subjekti nuk ka paraqitur parashtresa¹, si edhe ka zgjedhur të mos shprehë vullnetin e tij, duke mos u paraqitur as në seancën dëgjimore publike.

2. Në Apelin-kundërshtues, datë 19.5.2023, subjekti pretendon *se përfundimi i marrëdhënies së punës si ndihmës ligjor pranë Gjykatës së Lartë, ka ardhur për shkaqe ligjore dhe jo si pasojë e një kërkesë të shprehur nga ana e tij apo vullnetit personal²... nuk ka asnjë akt dorëheqje, ... pavarësisht përfundimit të marrëdhënies së punës në mënyrë të njëanshme nga ana e Kryetarit të Gjykatës së Lartë³. Kërkimi përfundimtar i subjektit në Apelin-kundërshtues është rrëzimi i ankimit të Komisionerit Publik si i pambështetur në prova dhe në ligj⁴.*

2.1 Subjekti në parashtresën e tij, datë 25.6.2024, për herë të parë, vetëm në fazën e gjykimit para Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në kundërshtim me afatet e parashikura në nenin 63 të ligjit nr.84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, që parashikon që vendimet e Komisionit ankimohen nga subjekti i rivlerësimit 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit, në nenin 44⁵ të ligjit nr. 49/2012 “ Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” (i ndryshuar), si dhe dispozitat e Kodit të Procedurës Civile, në kërkimin përfundimtar kërkon si kërkim alternativ, prishjen e vendimit të Komisionit nr.657/2023 dhe urdhërimin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për vijimin e procesit të rivlerësimit. Proceduralisht, vlerësojmë që ky pretendim nuk mund të ngrihet para Kolegjit, pasi vendimi nr.657/2023 i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në nenin 443 të K.Pr.Civile duhet të ishte kundërshtuar nga subjekti brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, i cili është afati i vetëm prekluziv i parashikuar për ankimin. Bazuar edhe në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese⁶ vlerësojmë se neni 444 i K.Pr.C-së është një dispozitë procedurale, e cila përcakton momentin e fillimit të llogaritjes së afatit të ankimit për palët ndërgjyqëse. Sipas paragrafit të parë të kësaj dispozite “*afatet e caktuara në nenin e mësipërm janë të prerë dhe fillojnë nga dita e nesërme e shpalljes së vendimit përfundimtar*”.

2.2 Bazuar në nenin 459 të Kodit të Procedurës Civile⁷ që parashikon sanksionin e prekluzivitetit për çdo mungesë kontestimi të shkaqeve të ankimit në tekstin e ankimit brenda afatit ligjor, dhe sipas modaliteteve respektive të zhvillimit të gjykimit, vlerësojmë se subjekti për herë të parë ka paraqitur si *kërkim të ri, në Kolegj prishjen e vendimit të Komisionit*

¹ Referohuni parashtresës së subjektit para Kolegjit datë 25.6.2024, f.7.

² Referohuni Apelit kundërshtues të subjektit datë 19.5.2023, f.5.

³ Referohuni Apelit kundërshtues të subjektit datë 19.5.2023, f.6.

⁴ Referohuni Apelit kundërshtues të subjektit datë 19.5.2023, f.10.

⁵ Mjetet dhe afatet e ankimit të vendimeve të gjykatave administrative janë të njëjta me ato të parashikuara në Kodin e Procedurës Civile, përveç kur parashikohet ndryshe në këtë ligj.

⁶ Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr.156 datë 22.7.2016.

⁷ *Kjo dispozitë parashikon se: “1. Kur kërkimet dhe pretendimet e papranuara nga gjykata e shkallës së parë nuk përsëriten në ankim, konsiderohet sikur është hequr dorë prej tyre.2. Në ankim nuk mund të parashtrihen kërkime të reja që nuk janë parashtruar në gjykimin në shkallë të parë.”*

nr.657/2023 dhe urdhërimin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për vijimin e procesit të rivlerësimit, kërkim i cili nuk është parashtruar në gjykimin në shkallë të parë në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.”

2.3 Kalimi i afatit në rastin konkret nga ana e subjektit të rivlerësimit ka shuar të drejtën e ankimit për këtë kërkim, dhe bashkë me të, edhe të drejtën për akses në juridiksionin gjyqësor rishikues të Kolegjit, dhe si i tillë kërkimi për prishjen e vendimit të Komisionit nr.657/2023 dhe urdhërimin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për vijimin e procesit të rivlerësimit ka rënë në dekadencë, dhe bazuar edhe në jurisprudencën e Kolegjit⁸, nuk duhet të pranohet nga ana e Kolegjit.

3. Lidhur me kërkimin tjetër të subjektit, lënien në fuqi të vendimit të Komisionit nr.657/2023, ndryshe nga sa ka pretenduar subjekti *se përfundimi i marrëdhënies së punës pranë Gjykatës së Lartë, në çdo rast ka përfunduar ispo jure, për shkak të vullnetit të Gjykatës së Lartë dhe jo prej vullnetit tim*⁹, Komisioneri Publik vlerëson se nuk qëndron edhe për arsyet si më poshtë.

3.1 Komisioneri Publik, sikundër Kolegji ka arsyetuar në vendimin e tij nr. 23/2024 (i shkurtuar) vlerëson të një rëndësie thelbësore për zgjidhjen e çështjes, analizimin e fakteve dhe rrethanave që tregojnë nëse subjekti i rivlerësimit hoqi dorë nga të drejtat që i buronin nga statusi i ndihmësit/këshilltarit ligjor në Gjykatën e Lartë me vullnetin e tij, apo nga ngjarje që nuk vareshin prej këtij vullneti. Në vlerësimin e Komisionerit Publik rezultoi se akti nëpërmjet të cilit subjekti i rivlerësimit është liruar nga detyra është në mungesë të kompetencës ligjore të Kryetarit të Gjykatës së Lartë. Konkretisht, kuadri ligjor që prezantohet pas hyrjes në fuqi të ligjeve nr. 76/2016¹⁰, nr. 96/2016¹¹ dhe nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, rezultoi se ishte i tillë që garantonte qëndrimin në detyrë të ndihmësve ligjorë që gëzonin statusin e subjektit të rivlerësimit deri në përfundimin e procesit të rivlerësimit kalimtar, dhe organi kompetent që vendoste për vijueshmërinë e marrëdhënies së tyre të punësimit ishte Këshilli i Lartë Gjyqësor.

3.2 Përsa më sipër, urdhri i Kryetarit të Gjykatës së Lartë për lirimin e subjektit nga detyra, për shkak të këtyre ndryshimeve ligjore, nuk përbën arsye ligjore për përfundimin e marrëdhënies së punësimit të subjektit të rivlerësimit, në kuptim të nenit 165, paragrafi 2 i ligjit nr. 96/2016. Ky urdhër është nxjerrë në mungesë të kompetencës së Kryetarit të Gjykatës së Lartë dhe, si rrjedhim, duhet të konsiderohet absolutisht i pavlefshëm, në kuptim të nenit 108,

⁸ Referohuni vendimit (JR) nr. 21 datë 13.5.2024.

⁹ Referohuni parashtrësës së subjektit para Kolegjit, datë 25.6.2024, f.20.

¹⁰ Pika 4 e nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i cili parashikon “[4.] Të gjithë këshilltarët ligjorë pranë Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, ndihmësit ligjorë pranë gjykatave administrative, ndihmësit ligjorë pranë Prokurorisë të Përgjithshme do të rivlerësohen ex officio. Procesit të rivlerësimit mund t’i nënshtrohen me kërkesë dhe nëse plotësojnë kriteret sipas ligjit edhe ish-gjyqtarët, ish prokurorët, ish këshilltarët ligjorë të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, të cilët kanë punuar në këto pozicione të paktën tre vjet. [...]”

¹¹ Neni 165, pikat 1 dhe 2 që parashikojnë “1. Këshilltari i gjyqtarit pranë Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, ndihmësi ligjor pranë Prokurorisë e Përgjithshme dhe në gjykatat administrative, si dhe inspektori në Këshillin e Lartë të Drejtësisë, që nuk gëzon statusin e gjyqtarit ose prokurorit, janë subjekt i procesit të rivlerësimit, në përputhje me ligjin “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. 2. Subjektet e parashikuara në pikën 1, të këtij neni, vazhdojnë të qëndrojnë përkohësisht në detyrë, në përputhje me parashikimet ligjore, përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, përveç kur marrëdhënia e punës përfundon për arsye ligjore, ose si rezultat i procesit të rivlerësimit, në përputhje me ligjin “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. [...]”

germa “ a ”, pika (i) e ligjit nr. 44/2015 “ Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”. Pra, urdhri i lirimit të subjektit nga detyra nuk ka sjellë asnjë pasojë juridike, pavarësisht faktit nëse është konstatuar apo jo si i tillë dhe konsiderohet se nuk ekziston. Për pasojë, subjekti i rivlerësimit nuk e ka humbur statusin e ndihmësit ligjor dhe ndërprerë marrëdhënien e punës, për shkak të këtij urdhri.

3.3 Nga ana tjetër, duket se subjekti i rivlerësimit e ka humbur statusin, për shkak të veprimeve dhe mosveprimeve të tij, në kushtet kur, ndërsa nuk kontestoi Urdhri nr.*** datë **.7.2017, të Kryetarit të Gjykatës së Lartë për lirimin nga detyra të subjektit në rrugë ligjore, ka shfaqur vullnetin për të ekzekutuar vendimin nr.***/2015 të Gjykatës së Apelit Administrativ Tiranë, duke filluar punë në Ministrinë e Drejtësisë, në pozicionin e inspektorit pranë Drejtorisë së Inspektimit Gjyqësor. Kjo sjellje e subjektit, referuar edhe trajtimit të situatave të ngjashme nga Kolegji në jurisprudencën e tij, konsiderohet si shkak për përfundimin e marrëdhënies së punës si ndihmës ligjor në Gjykatën e Lartë, dhe përmbush kushtet për t’u kualifikuar si dorëheqje nga detyra, në kuptimin e nenit G të Aneksit të Kushtetutës.

3.3.1 Komisioneri Publik, ndryshe nga sa ka pretenduar subjekti në prapësimet e tij¹², që çështjen e ka ndjekur dhe në rrugë gjyqësore pas nxjerrjes së Urdhrit nr.*** datë **.7.2017, të Kryetarit të Gjykatës së Lartë, si dhe është në pritje për t’u gjykuar pranë Gjykatës së Apelit Administrativ të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. Rrjedhimisht, vullneti im për të kundërshtuar vendimarrjen e (ish) Kryetarit të Gjykatës së Lartë mbetet i pandryshuar, konstaton se, referuar përmbajtjes së kërkesë-padisë datë **.7.2017, të dorëzuar si provë nga vetë subjekti i rivlerësimit, objekt gjykimi nuk ka qenë Urdhri nr.*** datë **.7.2017, i Kryetarit të Gjykatës së Lartë për lirimin nga detyra të subjektit, por me këtë kërkesë-padi, subjekti ka kërkuar¹³ rregullimin e pasojave financiare që kanë ardhur nga urdhri i pezullimit nga detyra datë **.7.2016, për periudhën kohore nga data **.7.2016 deri në përfundimin e marrëdhënies së punës.

3.3.2 Nga mënyra sesi paraqitet, në parashtrësën datë 25.6.2024 të subjektit para Kolegjit, duket sikur procesi i emërimit në pozicionin e inspektorit pranë Drejtorisë së Inspektimit Gjyqësor, në Ministrinë e Drejtësisë, rrjedh nga ekzekutimi i vendimit nr.***/2015 të Gjykatës së Apelit Administrativ Tiranë, dhe jo nga vullneti i subjektit. Nëse ekzekutimi i këtij vendimi, që e solli në detyrën e inspektorit pranë Drejtorisë së Inspektimit Gjyqësor, në Ministrinë e Drejtësisë, do të kishte qenë në kundërshtim me vullnetin e tij, atëherë duket se subjekti ka pranuar të kryejë një detyrë duke cenuar lirinë e tij për punë, në kundërshtim me përcaktimet e nenit 26 të Kushtetutës, sipas së cilit askujt nuk mund t’i kërkohej kryerja e një pune të detyruar, përveçse në rastet e përcaktuara në këtë dispozitë.

4. Komisioneri Publik, ndryshe nga sa ka pretenduar subjekti në prapësimet e tij¹⁴, që nuk ka një akt dorëheqje të shprehur nga ai, dhe rrjedhimisht nuk mund të aplikohet ndaj tij neni G i Aneksit të Kushtetutës, pasi aplikimi i kësaj dispozite lidhet pazgjidhshmërisht me shprehjen

¹² Referohuni parashtrësës së subjektit të dorëzuarë në senacën gjyqësore para Kolegjit datë 25.6.2024, f.18.

¹³ - Detyrimin e palës së paditur, Gjykata e Lartë të paguajë pagat e papaguara me interesat përkatës për periudhën kohore **.7.2016 deri në përfundimin e marrëdhënies së punës.- Detyrimin e palës së paditur, Gjykata e Lartë të kryejë derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore të paditësit për periudhën kohore **.7.2016 deri në përfundimin e marrëdhënies së punës.- Detyrimin e palës së paditur, Gjykata e Lartë të paguajë lejen vjetore për vitin 2016 dhe 2017.

-Detyrimin e palës së paditur, Gjykata e Lartë të paguajë shpërblimin për vjetërsi në punë në masën e 3 pagave mujore.

¹⁴ Referohuni parashtrësës së subjektit para Kolegjit, f.30 datë 25.6.2024.

*e vullnetit të personit, vlerëson se jurisprudenca e Kolegjit ka qartësuar institutin e dorëheqjes, sipas të cilës konsiderohet dorëheqje e subjektit, edhe mungesa e një akti formal të shkruar, e cila po ashtu edhe në të tilla raste, passjellë aplikimin e nenit G të Aneksit të Kushtetutës. Konkretisht, në jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit¹⁵ parashikohet se [...] në kontekstin edhe të orientimit të dhënë nga ana e Kolegjit për verifikimin e vullnetit për dorëheqjen e subjekteve të rivlerësimit, vlerëson se konstatimi i mungesës së një akti formal të shprehjes së vullnetit për dorëheqje nga detyra, sikundër dhe mungesa e një akti formal të dhënies së pëlqimit për të ushtruar detyrën e re, nuk mund ta përjashtojnë subjektin e rivlerësimit nga përcaktimi i nenit G të Aneksit të Kushtetutës, për sa kohë rezultoi që emërimi në detyrën e re nuk është kundërshtuar prej tij. Një sjellje e tillë e subjektit me të drejtë është vlerësuar nga Komisioni si shprehje në heshtje e vullnetit të subjektit të rivlerësimit¹⁶, znj. *** ***, për t'u larguar nga detyra e ndihmëses ligjore dhe njëkohësisht për t'u shmangur nga procesi i rivlerësimit kalimtar, për sa kohë rikthimi në detyrën që e mbante znj. *** *** në procesin e rivlerësimit, nëpërmjet ankimit, ishte një mundësi ligjore, e përjashtuar me vullnetin e saj të lirë. Në vijim të analizës së mësipërme, përfundimi i marrëdhënies së punës së subjektit të rivlerësimit, znj. *** ***, si ndihmëse ligjore në Prokurorinë e Përgjithshme nuk ka ndodhur për shkaqe ligjore referuar parashikimit të nenit 165 të ligjit nr. 96/2016 dhe, për pasojë, procesi i rivlerësimit nuk mund të deklarohet i përfunduar pa një vendim përfundimtar, por veçse të ndërpritet në zbatim të përcaktimeve të nenit G të Aneksit të Kushtetutës[...]*

II. Kërkimi përfundimtar i ankimit.

5. Komisioneri Publik, mbështetur në sa më sipër trajtuar, bazuar në dispozitën e pikës 3 dhe 7 të nenit F, të aneksit të Kushtetutës, shkronjës “c”, të pikës 1, të nenit 66 të ligjit nr. 84/2016, kërkon nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelit të vendosë:

- Ndryshimin e vendimit nr. 657, datë 28.4.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në këtë mënyrë:

1. *Ndërprerjen e procesit të rivlerësimit ndaj subjektit, z. Periand Teta.*
2. *Ndalimin e subjektit të rivlerësimit, z. Periand Teta, të emërohet gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshme për një periudhë 15-vjeçare.*

KOMISIONERI PUBLIK

Irena NINO

¹⁵ Referohuni vendimit (JR) nr.35 datë 27.7.2023 për subjektin e rivlerësimit ***.***; vendimit (JR) nr.23 datë 21.5.2024, për subjektin e rivlerësimit ***.***.

¹⁶ Shih pjesën e fundit të paragrafit nr. 23.4 të vendimit të Komisionit.